

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryedemokrati hap seancën plenare me Vlora Hysenin: Fuqia iu dha nga padrino i vendit! Agasi ju shkar konte, ju thërriste në zyrë, Damian e di ti...
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/berisha-hap-seancen-plenare-me-vlora-hysenin-fuqia-iu-dha-nga-padrino-i401956
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 08:46:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 08:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	81ce62a9e96b57fb7df28acdbdb98063fe19616181041b32b793e82da453210e
TEKSTI	8569260570193e01c5d25626aa2527e6460e83de0e6f5ed72b8aaae33ec95414
PAMJA	463670915805768c5a513bda115b47c0555b3fa61cb28eb36a4d401d71dc9f4e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86dbd808b9b7799e5ac1be2282b2a6d9bf917ba2863d0cf1834887ff4a07119b
E MËPARSHMJA	6dfde786dfa2aa6be585f133ddf44a50bb9323d4e1a486d93fbed098c5264931
RRËNJA MERKLE	34bf9fb855e0215b8384019a592b192cd8415b3fea3e8d3a2dd71c749e8b79fe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86dbd808b9b7799e5ac1be2282b2a6d9bf917ba2863d0cf1834887ff4a07119b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Politikë

24 Shtator 2026, 10:41

Kryedemokrati hap seancën plenare me Vlora Hysenin: Fuqia iu dha nga padrino i vendit! Agasi ju shkarkonte, ju thërriste në zyrë, Damian e di ti...



Shkruar nga Newsbomb



Sali Berisha, Kuvend

Seancën e sotme plenare e ka hapur lideri demokrat Sali Berisha i cili hapi punimet e sotme në Kuvend me në fokus arrestimin e shefes së SHISH-it, Vlora Hysenit të cilën e cilësoi se është "El Porro" i Shqipërisë. Ndërsa akuzoi kryeministrin Edi Rama se e emëroi në krye të detyrës shërbëtoren e Vucicit.

"Në këtë sallë kam paralajmëruar se Ergys Agasi është mafiozi më i rrezikshëm në botë. Të gjitha sekretet e këtij shteti, ai kishte fuqi të pakufizuar, fuqi që iu dha nga padrino i vendit.

Rasti i Vlora Hysenit është i treti rast në botë, është El Porro i Venezuelës që punojnë me kartelet e shefit të shërbimit" tha Berisha gjatë fjalës së tij.

Duke akuzuar se emërimi i Hysenit është bërë për rol të dyfishtë, sipas Berishës me urdhër të Ergys Agasit janë bërë shkarkime të shumë zyrtarëve. Lideri demokrat iu drejtuar socialistit Damian Gjikhurit të cilët i tha: **Ishte njeriu që iu thërriste në zyrë, Damian e ke vetë parasysht ti. Tragjike është se është shembur piramida e sigurisë.**

Këshilluar për ty



Berisha insinuo se ka dosjen

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Përplasje në GJKKO, Vlora Hyseni akuzon gazetaren Klodiana Lala: Si kalon ti në takime me agjentët serb në dhomat e hotelit Rogner?



Aktualitet

Vlora Hyseni mbërrin në SPAK 10 minuta para atarit, do pyetet nga prokurorët për Ergys Agasin

Zbulu më shumë artikuj >



Hyseni/Agasi: Damian, shin se gjen veten aty! Ulusi, të del emri në shumë faqe (DEKLARATAT)

Fjala e Sali Berishës:

Ky është parlamenti i Ergys Agasit, Vlora Hyseni shkarkonte secilin prej jush me porosi të tij! Siguria kombëtare është shembur totalisht, Agasi e merite fuqinë nga Padrinoja Edi Rama

Kjo seancë do hyjë në histori si seanca më e turpshme e mbledhur ndonjëherë.

Sot parlamenti mblidhet si parlamenti i Ergys Agasit, si parlamenti më i papërgjegjshëm në tërë historinë kombëtare të ndonjë vendi.

Sot, për çdo qytetar shqiptar, që i thotë vendit vend, sigurisë siguri, çështja e të gjitha çështjeve është shembja totale e sigurisë së vendit pasi kryetarja e shërbimit informativ rezulton një anëtare e poshtër e grupit të strukturuar kriminal Agasi.

Në këtë sallë kam deklaruar, kam paralajmëruar se Ergys Agasi është mafiozi më i rrezikshëm i Evropës.

Po, sepse ai kontrollonte si asnjë tjetër në Shqipëri dhe në Evropë, të gjitha kartelet e drogës, të gjithë internetin e territorit të vendit, të gjitha sekretet e këtij shteti dhe SHISH-in.

Ai kishte fuqi të pakufizuar dhe këtë fuqi e kishte nga Padrino i vendit.

Rasti i Vlora Hysenit është i treti rast në botë, është El Polo i Venezuelës që punoi me kartelet, është shefi i shërbimit të Guinesë Bisau, të cilën kartelet amerikano-latine e shndërruan në narkoshtetin e parë dhe të vetëm në Afrikë, dhe tani vjen Vlora Hyseni, ky personazh i përcudnuar, që pasi shkarkohet nga detyra në një vend demokratik, për motive të forta, po ato motive e sjellin atë këshilltare të Padrinos dhe më pas e sjellin në krye të SHISH.

Emërimi i saj, jashtë të gjitha kriterëve, përbën aktin më të papërgjegjshëm ndaj sigurisë së vendit. Emërimi i saj ishte në mënyrë absolute për një rol të dyfishtë. E kam deklaruar në atë kohë, e deklaroj edhe sot, ajo ishte një shërbëto e Vuçiçit dhe Edi Ramës.

Por kjo është njëra anë, ana më e zezë është se njeriu që kishte për detyrë sigurinë e vendit dhe qytetarëve të këtij vendi, bashkëpunonte me hanxharët e krimit, ishte një ushtar e hanxharëve të krimit. Ishte ushtar e një organizate më të rrezikshme kriminale.

Ishte njeriu që lëshonte në duart e bandave çdo sekret të këtij shteti. Ishte njeriu që me porosi të Ergys Agasit shkarkonte secilin prej jush. Po! Ishte njeriu që u thërriste ju në zyrë. Damian, e ke vetë parasysh ti. Nuk je i vetmi ti, janë shumë si ti. Se e shihja se po bëje sikur nuk po dëgjoje.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





E Enjte 11:50

Vlora Hyseni "fikte radarët" për Ergys Agasin, Berisha ngre dyshime edhe për ministren socialiste, e pyet në Kuvend: Keni kaluar ju zonjë nga zyra e tij?



Politikë

Tensione në Kuvend, Flamur Noka merr "peng" foltoren, Peleshi përplasat me Topallin: Ç'a ke, ç'a ke...hajde këtu hajde..

E Enjte 11:29



Politikë

Berisha insinuat se ka dosjen Hyseni/Agasi: Damian, shih se gjen veten aty! Ulu! të del emri në shumë faqe (DEKLARATAT)

E Enjte 10:43



E Mërkurë 20:16 Newsbomb

"Shteti i gysrave!" Saliانji "shpërthen" pas arrestimit të shesës së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGMI)



Politikë

PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Vlora Hysenin


E Mërkurë 19:44 Newsbomb



Politikë

Klodiana Lala paralajmëron nga zyra e Fevziut: Mbaje shënim, do dalin të dhëna që s'i kishte imagjinuar ndonjëherë

E Mërkurë 14:08



🕒 E Mërkurë 13:35

Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe më shumë mundësi nga fondet e BE-së



Politikë

Ish-kreu i SPAK ia firmosi masat e sigurisë, gazetari jep detaje: Vlora Hyseni pinte kafe njëherë në javë me Altin Dumanin...

🕒 E Mërkurë 13:08



Politikë

Akuzat e opozitës, ministrja Spahiu pret në zyrë qytetarin: Rastin e Albi Sulës do ta ndjekim në Turqi! Mos bëni politikë me shëndetin e tij

🕒 E Mërkurë 11:39



🕒 E Mërkurë 11:06

"Ka rënë shteti, Kuvendi flet për s*ksin e engjëjve", përplasje te "Ligjet" pas skandalit me SHISH-in, demokratët kërkojnë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë





Politikë

Një ditë pas goditjes së SPAK ndaj SHISH-it, demokratët mbledhen në seli, Berisha thërret Kryesinë e re

🕒 E Mërkurë 10:08



Politikë

Balla dhe Tarquinio dalin me DEKLARATË për takimin dyditor për anëtarësimin në BE: Gati deri në fund të 2027

🕒 E Martë 17:08 Newsbomb



Politikë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.